

Të nderuar anëtarë të kishës tonë:

Këto muaj që kanë kaluar kanë qenë ndryshe nga të tjerët në jetën tonë. Pandemia e Covid-19 ka kthyer jetën tonë përmbys. Shumica prej nesh ka pasur kohë të mendojë, të shqyrtojë, vlerësojë dhe të lutet për atë që është me të vërtetë e rëndësishme në jetën tonë. Shumë prej nesh kanë kaluar më shumë kohë me anëtarët e familjes (përfshirë të rriturit e rinj që janë kthyer në shtëpi) se kurrë më parë. Ka qenë shume ndyshe! Familja e kishës tonë nuk ka mundur të mblidhet që nga Liturgjia jonë e fundit Hyjnore e 8 Marsit. Kemi kaluar Lentet e Mëdha, Pashkën, Ngjitja dhe së fundmi Pentekosti (50 ditë pas Pashës!) Ne kemi pasur mundësinë të shohim shërbime të drejtpërdrejta - por përfundimisht nuk është si të jesh në kishë! Gjithashtu jemi mbledhur on-line për orën e kafesë me Zoom me At Dennis të dielave në orën 12:00. Vizitorët kanë qenë të mrekullueshëm. Ata na kanë lejuar të dëgjojmë dhe diskutojmë mësimin e Ungjillit dhe të qëndrojmë në kontakt me vëllezërit dhe motrat tona në Shën Gjonit.

Perveç pandemisë, vendi ynë i madh është ndeshur me protesta të shumta për vrasjen e një Afrikan-Amerikan në duart e një oficeri policie. Ky incident, tregoi edhe njëherë trajtimin e njerëzve me ngjyra nga disa anëtarë të departamenteve të policisë së kombit tonë. Në fillim, protestat u pasuan me plaçkitje në një numër të qyteteve në të gjithë vendin, përfshirë dhe Filadelfia. Fatmirësisht, pas javës së parë plaçkitja ka rënë. Protestat - këtu në Filadelfia, si dhe në të gjithë vendin - vazhdojnë por, për pjesën më të madhe janë shumë paqësore.

Sinodi i Shenjtë i Peshkopëve të Kishës Ortodokse në Amerikë lëshoi një

deklaratë e cila përfshin si vijon:

"Ne e kundërshtojmë kategorikisht racizmin në çfarëdo forme. Çdo qenie njerëzore është krijuar në imazhin dhe ngjashmërinë e Zotit (Zanafilla 1: 26-27) dhe u krijua që të ekzistonte (Urtësia e Solomonit 1:14). Ne jemi të gjithë, secili nga ne, "një në Jezu Krishtin (Galatasve 3:28). "Si i tillë, nuk duhet të ketë urrejtje, armiqësi, midis nesh, por pajtimi.

Këshilli i bordit të kishës pajtohet plotësisht me deklaratën e lëshuar nga Sinodi i Shenjtë i Peshkopëve.

Kisha jonë e vogël, Shën Gjonit, është vetëm disa blloqe larg nga ku ndodhën shumë nga protestat dhe incidentet e plaçkitjeve në Filadelfia. Për fat të mirë, kisha jonë nuk u dëmtua në asnjë mënyrë.

Nga ana tjetër, këshilli i kishës është njoftuar për një çift personash të lidhur me kishën tonë që kanë kontraktuar virusin Covid-19. Falënderojmë Zotin që ata janë më mirë e tani janë shëruar.

Më 19 qershor këshilli i kishës u mbledh në Zoom mbledhje. Diskutimi ynë u përqendrua rreth rihapjes së propozuar të Shën Gjon Gojartit. Artikujt që diskutuam janë renditur në faqet që pasojnë.

1. Data e propozuar për të festuar Liturgjinë Hyjnore në Kishën e Shën Gjonit Chrysostom tani është 12 korrik, ora 10:00.

2. Fleta e regjistrimit për ata që duan të marrin pjesë do të jetë postuar në faqen tonë të website (do të sigurohet një lidhje kur të konfirmojmë datën që do të rihapemi) ose ata mund të telefonojnë 609-685-1651 për të treguar se planifikojnë të marrin pjesë në Liturgji. Nëse më shumë njerëz duan të marrin pjesë sesa mund të strehohen në mënyrë të pranueshme (sipas udhëzimeve të Qytetit të Filadelfias) ne do të shkojmë alfabetikisht dhe ata që nuk janë në gjendje të marrin pjesë do të jenë të parët në listë për javën në vijim. Ju lutemi përpuni të vini përpara orës 10 që të kemi kohë të rregullojmë vendet ku do uleni duke respektuar distancën sociale. Gjithashtu Liturgjia Hyjnore do të transmetohet live në Youtube.

3) Marrëveshje mund të bëhet nëse një familje dëshiron të ketë një Shërbim Përkujtimor. Ju lutemi dërgoni me email në info@stjohnsphila.org ose telefononi 609-685-1651. Familjet me një Memorial të caktuar do të vendosen në krye të listës së pjesëmarrësve.

4) At Dennis do të shërbejë së bashku me një shërbyes në Altar (do të bëhet një orar për shërbyesit e altarit)

5) Të gjithë të pranishëmve do t'u kërkohet të vendosin maskën ndërsa ndodhen brenda në kishë dhe afër territorit të kishës. (ne kemi mund tju japim një maskë në rast se harroni të sillni maskën tuaj). Mbajtja e maskës për fëmijët e moshës 2 deri 5 vjeç do të gjykohet nga prindërit e tyre. Fëmijët nën moshën 2 vjeç nuk do t'ju kërkohet të mbajnë maskë në fytyrën e tyre.

6) Një person i caktuar do të vendoset jashtë derës së përparme për të matur temperaturën e atyre që hyjnë në kishë. Pjesëmarrësit inkurajohen të masin temperaturat e tyre para se të dilnin nga shtëpia e tyre në mëngjes. Ata persona që ka një temperaturë mbi 100.4 ° nuk duhet të vijë në kishë.

7) Një person i caktuar do të jetë në stendën e qirinjve me një listë të paracaktuar të atyre që janë regjistruar për të marrë pjesë për të konfirmuar pjesëmarrjen (informacioni do të përdoret për ndjekjen e kontaktit nëse është e nevojshme). Lista do të përpilohet duke përdorur informacionin nga ata që janë regjistruar on-line ose që kanë telefonuar për pjesëmarrjen e tyre. Ndërsa fillojmë procesin tonë të rihapjes, ju lutemi njoftoni në avancë për ardhjen tuaj. Ne duhet të dimë emrat e atyre që marrin pjesë në mënyrë që të mund të mbajmë një llogari të duhur për të ruajtur distancimin shoqëror.

8) Personat që vijnë në kishë do të jenë në gjendje të blejnë dhe të ndezin qirinj. Qirinjtë mund të parapagohen në faqen tonë të internetit. Këshilli i famullisë do të jetë i disponueshëm për të ndezur qirinjtë e parapaguar për ata që nuk janë në gjendje të marrin pjesë fizikisht. Doreza plastike do të jenë në dispozicion për ju që t'i përdorni për të marrë dhe ndezur qirinjtë. Ju lutemi sillni vlerën ekzakte të parave për qirinjtë që të shmangim kusurin dhe kontaktet e panevojshme; qirinjtë e hollë janë 1.00 dollarë dhe qirinjtë e trashë janë 2.00 dollarë secila.

9) Kartat e lutjeve të laminuara do të jenë në dispozicion në stendat e qirinjve dhe ato mund të marren kur të largoheni. Të gjitha Librat e Liturgjisë dhe kartat e lutjes janë hequr nga pjesa e prapme e stolave.

10) Nderoni ikonën, por mos e puthni ikonën ose stendën. Mos puthni ose përçafoni askënd - distancimi shoqëror do të praktikohet. Vendet e përcaktuara për t'u ulur do të shënohen qartë në stolat. Familjet do të ulen së bashku.

11) At Dennis do të shpjegojë të pranishëmve, të cilët dëshirojnë, si mund të marrin kungimin. Nëse një i pranishëm nuk mendon se është e drejtë të marrë kungimin, ata mund - pa ndonjë faj ose gjykim nga të tjerët - të mos afrohen për marrjen e kungimit.

12) Kori do të zhvendoset në pjesën e përparme të kishës - aty ku ata qëndrojnë gjatë liturgjisë së shenjtëruar. Drejtori i Korit, Vlad Melnik, do të koordinojë pjesëmarrjen e korit.

13) Shporta e mbledhjes së ndihmave nuk do të pasohet më. Shporta do të jetë e disponueshme në stendën e qirinjve për të bërë një dhurim nëse dëshironi.

14) Kisha do të pastrohet dhe dezinfektohet para Liturgjisë të së Dielës. Banjat do të jenë në dispozicion për të pranishmit. Kujtesë - lani duart tuaja. Sanitizuesi i duarve është i disponueshëm kur hyni dhe dilni nga kisha.

15) Nuk do të ketë orë kafeje pas Liturgjisë. Për ata që dëshirojnë të bisedojnë me pjestarë e pranishëm të tjerë, mund ta bëni këtë jashtë kishës, për sa kohë që të dy palët bien dakord. Ju lutemi mbani maskat veshur dhe ruani distancën shoqërore.

16) Nëse dikush që ka qenë prezent në Liturgjinë Hyjnore sëmuret, do t'ju kërkohet ta mbyllim kishën për 2 javë. Do të na kërkohet gjithashtu t'i përmbahemi Protokollit të vendosur nga Qyteti i Filadelfisë dhe t'i raportojmë të gjitha diagnozat Covid-19 në Bordin e Shëndetësisë.

17) Ata individë që konsiderohen të rrezikuar nxiten të mbrojnë shëndetin e tyre duke qëndruar në shtëpi. Mitropoliti Tikhon dhe At Dennis ju sigurojnë se kjo është mirë në sytë e kishës. Shëndeti juaj ka një rëndësi parësore.

Këshilli i Kishës: Linda Biando, Donna Dimitri, Sergio Georgi, Wes Hanson, Fiori Papa, Nilda Salavachi, Elena Shomos